

V E N D I M
Nr.103, datë 27.2.1999

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR PËR DECENTRALIZIMIN E PUSHTETIT VENDOR DHE MIRATIMIN E PROJEKTPLANIT STRATEGJIK TË DECENTRALIZIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komitetit Kombëtar për Decentralizimin e Pushtetit Vendor. Ky Komitet ngarkohet të hartojë, të ndjekë dhe të zbatojë “Planin strategjik të decentralizimit dhe të modernizimit institucional të pushtetit vendor”.

Komiteti Kombëtar për Decentralizimin e Pushtetit Vendor të ushtrojë funksionet e tij deri në fund të vitit 2000.

Këshilli i Ministrave, nëse e gjykon të nevojshme, mund të vendosë ushtrimin e funksioneve të këtij Komiteti përtej afatit të parashikuar më sipër.

2. Komiteti Kombëtar për Decentralizimin e Pushtetit Vendor drejtohet nga zëvendëskryeministri dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar dhe ka në përbërje:

1. Ministrin e Shtetit për Reformën Legjislative,
2. Ministrin e Financave,
3. Ministrin e Drejtësisë,
4. Ministrin e Pushtetit Lokal,
5. Drejtorin e Departamentit të Administratës Publike,
6. kryetarët e shoqatave të të zgjedhurve vendorë.

3. Komiteti Kombëtar për Decentralizimin e Pushtetit Vendor koordinon veprimtarinë në fushën e reformës së decentralizimit, si dhe të gjithë veprimtaritë dhe projektet e donatorëve të huaj, në mbështetje të këtij procesi.

4. Në funksion të veprimtarisë së Komitetit Kombëtar për Decentralizimin e Pushtetit Vendor, pranë Ministrisë së Pushtetit Lokal funksionon grupi i ekspertëve, nën drejtimin e Zëvendësministrit të Pushtetit Lokal. Ky grup përgatit materialet, që shqyrtohen e miratohen nga Komiteti Kombëtar për Decentralizimin e Pushtetit Vendor dhe i raporton këtij Komiteti një herë në muaj.

5. Përbërja e grupit të ekspertëve vendoset nga Komiteti Kombëtar për Decentralizimin e Pushtetit Vendor. Në varësi të fushave dhe të çështjeve që trajtohen, në grupin e ekspertëve të caktohen drejtues në nivel drejtor drejtorie dhe ekspertë nga ministrinë, nga Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave, shoqatat e të zgjedhurve vendorë, institucionet shkencore, organizatat joqeveritare, si dhe ekspertë të huaj.

6. Miratohet “Projektplanin strategjik për decentralizimin e kompetencave dhe modernizimin institucional të pushtetit vendor”, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Koordinimit Qeveritar dhe Ministria e Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko